



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 351/1 Prot.

Tiranë, më 05.03. 2019

V E N D I M

Nr. 35., Datë 05 / 03 / 2019

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr.135 regj, datë 11.09.2018, të subjektit ankues, A. P, në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të “*bindjeve politike*¹” dhe të “*moshës*²”, nga ana e Shoqërisë Albpetrol sh.a.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi³,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Subjekti ankues, A. P ka filluar marrëdhëniet e punës pranë Uzinës Mekanike të Naftës Kuçovë, që prej vitit 2010, duke mbajtur pozicione të ndryshme pune. Në vitin 2014 është emëruar Ekonomist pranë Sektorit Mekanik, sektor i cili ka në përbërjen e tij 47 punëtorë. Ankuesi shprehet se gjatë periudhës që ka ushtruar këtë detyrë ka realizuar çdo objektiv duke dhënë rezultate konkrete, për të cilat dhe është vlerësuar verbalisht në çdo mbledhje të mbajtur me Administratorin e kësaj Shoqërie.

¹ Subjekti ankues provon anëtarësinë e tij në forcën politike të subjektit politik, Partia “Lëvizja Socialiste për Integrim”, me kartën e anëtarësisë me nr.23378 /Njësia Kuçovë.

² Subjekti ankues është i datëlindjes 09.06.1954 (rreth dy vite para daljes në pension)

³Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën KMD.

Me datë 17.07.2018 është njoftuar se marrëdhënia e punës me Shoqërinë Albpetrol sh.a do të ndërpritej me datë 19.10.2018.

A.P shprehet se e ka kundërshtuar pranë eprorëve të Shoqërisë këtë akt, duke kërkuar edhe shpjegimet përkatëse lidhur me ndjekjen e procedurës për largimin e tij.

Ai parashtron se procedura e ndjekur për largimin e tij nga puna është e pavlefshme, pasi nuk janë ndjekur dhe respektuar as procedurat ligjore dhe as kriteret e përcaktuara. A. P gjykon se nuk janë marrë në konsideratë për vlerësimin e tij:

- vjetërsia në punë, (37 vite në këtë profesion)
- diploma e shkollës së lartë, (arsimimi)
- mosha, (pasi në vitin 2019 plotëson moshën e pensionit)

Për më tepër, A. P pretendon se është zëvendësuar me një punonjës tjetër që nuk plotëson kriteret e kërkuara për pozicionin e punës.

Ankuesi shprehet se, në gjykimin e tij, sjellja e punëdhënësit (shoqërisë Albpetrol sh.a) ndaj tij ka patur një prapavijë politike, duke cituar se: *“..me të drejtën që më ka dhënë ligji unë jam zgjedhur anëtar i Këshillit Bashkiak të Bashkisë Kuçovë nga subjekti LSI. Gjithashtu aderoj në forume të këtij subjekti prej vitesh. Duke qenë se Administratorët janë direkt të zgjedhur prej drejtuesve të subjektit Partia Socialiste, kam krijuar bindjen e plotë që këta drejtues po përdorin mekanizma jo korrekte, si procedura diskriminuese për të bërë të mundur largimin tim nga puna”*.

Në përfundim të ankesës së tij, A. P kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi konstatimin e diskriminimit të tij nga ana e punëdhënësit, për shkak të bindjeve të tij politike.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10 221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Neni 7 i LMD-së⁴, në pikën 1 të tij, parashikon se: *“Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”*.

⁴Shkurtesë për Ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi.

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10 221/2010, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën me nr.1222/1 prot., datë 26.09.2018 i është kërkuar informacion dhe dokumentacion provues Shoqërisë Albpétrol sh.a, lidhur me pretendimet e subjektivit ankues.
- Me shkresën me nr.9315/1 prot., datë 11.10.2018⁵ Shoqëria Albpétrol sh.a, ka informuar Komisionerin se:

“Në zbatim të Programit të Zhvillimit të Rishikuar për vitin 2018, i miratuar me Vendimin nr.8, datë 07.06.2018 të Këshillit Mbikqyrës dhe Vendimit nr.496/10, datë 25.06.2018 të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Shoqëria Albpétrol sh.a, është në proces ristrukturimi për reduktimin e fuqisë punëtore dhe për këtë arsye ka ndërmarrë hapat për nisjen e procedurave të pushimit kolektiv. Në kuadër të këtij procesi është nënshkruar Akt-Marrëveshje me Organizatën Sindikale Përfaqësuese të punëmarrësve, për përcaktimin e kriterëve mbi të cilat do të kryhet procedura e pushimit kolektiv. Për kryerjen e vlerësimit dhe pikëzimin e punonjëve janë ngritur komisione të posaçme pune me urdhër të Administratorit të Shoqërisë Albpétrol sh.a. Shoqëria Albpétrol sh.a për të kryer një proces sa më transparent ka aplikuar një sistem përzgjedhje me anë të vlerësimit me pikë, mbi bazën e të cilit janë përzgjedhur se do të qëndrojnë në punë ata punonjës të cilët janë vlerësuar me më shumë pikë.

Në rastin konkret, ju sqarojmë se mbështetur në Strukturën e Re Organizative të miratuar për Qendrën Mekanike të Naftës Kuçovë (QMN) janë shkurtuar pozicionet e punës për Ekonomist Sektori përfshirë edhe pozicionin e punës së A. P si Ekonomist Normist në Sektorin Mekanik. Ndërkohë që në Administratën e kësaj qendre është shtuar një vend pune “Ekonomist”. Për këtë arsye A. P dhe punonjësit e tjerë me vend pune si Ekonomist Sektori iu nënshtruan procesit të vlerësimit dhe pikëzimit për konkurimin në vendin e shtuar si Ekonomist në Administratën e QMN Kuçovë.

⁵ Protokolluar me Tonën, me nr.1413 prot., datë 15.10.2018.

Përsa i përket kritereve mbi të cilat është kryer përzgjedhja e punonjësve së QSHGJ Patos që u prekën nga pushimi kolektiv, ju bëjmë me dije se u morën në konsideratë kriteret si më poshtë:

- *Arsimi.*
- *Kualifikimi profesional/kategoria/patentë/licensë specifike.*
- *Vjetërsia në punë.*

Referuar procesit të vlerësimit dhe pikëzimit të kryer për punonjësit me vend pune si Ekonomist Sektori në QMN Kuçovë, rezulton se A. P nuk plotëson kriteret e mjaftueshme për vazhdimin e marrëdhënieve të punës. Arsimi i tij nuk përputhet me kërkesat e strukturës së re organizative në të cilën është përcaktuar specialiteti “Financier”.

Në total, nga procesi i ristrukturimit të shoqërisë janë prekur rreth 450 punonjës të cilët janë njoftuar për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës bazuar në parashikimet e K.Punës.

Për sa i përket QMN Kuçovë janë shkurtuar 3 vende pune si Ekonomist Sektori ndërkohë që janë njoftuar për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës 2 punonjës. Bazuar në rezultatet e procesit të vlerësimit dhe pikëzimit të kryer pranë kësaj qendre, një prej punonjësve është sistemuar në pozicionin e punës si Ekonomist, shtuar në Administratën e kësaj qendre. Sa i takon kësaj qendre janë njoftuar për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës në total 22 punonjës.

Nga ana e Shoqërisë Albpetrol sh. a i është kthyer përgjigje me shkrim çdo pretendimi të ankuesit për zgjidhje të padrejtë të marrëdhënieve të punës.

Bazuar në sa më sipër, procedura e ndjekur nga QMN Kuçovë është konform legjislacionit në fuqi dhe urdhërave që kanë dalë në zbatim të procesit të ristrukturimit të kësaj shoqërie. Pozicioni i punës së A. P është shkurtuar dhe për këtë arsye ai i është nënshtruar procesit të vlerësimit bashkë me punonjësit e tjerë të sektorit përkatës.

Ndërprerja e marrëdhënieve të punës me punonjësin A. P, për shkak të numrit të punonjësve të përfshirë në proces, nuk vlerësohet si pushim individual por si pushim kolektiv (referuar pikës 1, të nenit 148 të K.Punës). Kjo do të thotë se marrëdhënia punëdhënës-punëmarrës, pra raporti midis Shoqërisë Albpetrol sh.a dhe A. P nuk është aspak individual dhe i lidhur me pretendimin e tij se është njoftuar për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës për shkak të bindjeve politike”.

2. Mbështetur në nenin 33, pika 8, të ligjit nr.10 221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës së A. P, Komisioneri me datë 11.12.2018⁶ realizoi një seancë dëgjimore me palët në proces.

Seanca u zhvillua me praninë e të dy palëve në proces: subjektit ankues, nëpërmjet përfaqësuesit me prokurë të posaçme⁷, E. P dhe palës kundër së cilës është paraqitur ankesa, përfaqësuesve me autorizim⁸ të Shoqërisë Albpetrol sh.a., Y. S dhe E. Ç.

⁶ Referuar “Njoftimit për seancë dëgjimore” me nr.1222/2 prot., datë 05.12.2018.

⁷ Me nr.2422 Rep. dhe Nr.1133 Kol.

Adresa: Rruga e Durrësit, Kodi postar 1001, (Ish-Ministria e Mjedisit), Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: info@kmd.al, web: www.kmd.al

Gjatë seancës dëgjimore, të dyja palët iu qëndruan të njëjtave parashtrime që kishin bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor me KMD-në. Nga ana e ankuesit u theksua fakti se pozicioni i tij i punës nuk ishte suprimuar dhe se personi që e ka zëvendësuar nuk përmbush kriteret e kërkuara. Po ashtu, ai theksoi faktin se është larguar nga puna vetëm 6 muaj para se të mbushte moshën për të dalë në pension.

Nga ana e përfaqësuesve të Shoqërisë u theksua sërish fakti i suprimimit të vendit të punës, të cilin para ristrukturimit e mbante subjekti ankues dhe se i gjithë procesi kishte qenë i hapur dhe transparent. U la si detyrë që në vijim nga Albpetrol sh.a të silleshin parashtrime dhe dokumentacion mbi numrin e të larguarve nga puna dhe që janë në moshë (deri në dy vite) para daljes në pension, të atyre që janë në marrëdhënie pune brenda kësaj fashe moshe (deri në 2 vite para daljes në pension), si dhe informacion lidhur me 3 punonjës: A. K, E.P dhe V.Gj.

3. Në vijim të procedurës hetimore për marrjen e çdo prove dhe informacioni që i shërben procesit, nëpërmjet shkresës me nr.111 prot., datë 22.01.2019 Komisioneri i është drejtuar Shoqërisë Albpetrol sh.a lidhur me kërkesën për dërgimin e informacionit dhe dokumentacionit të kërkuar gjatë seancës dëgjimore të datës 11.12.2018.

Me anë të shkresës me nr.47588 prot., datë 26.12.2018 Shoqëria Albpetrol sh.a informon Komisionerin, në vijim të detyrave të lëna gjatë seancës dëgjimore se: *“...lidhur me pretendimin e ankuesit për pozicionet e punës të 3 punonjësve sipërcituar, theksojmë se:*

- *Z.A. K para procesit të ristrukturimit ka mbajtur detyrën e specialistit të Kushteve Teknike dhe Preventivues dhe pas procesit të ristrukturimit mban detyrën e specialistit Teknik dhe Preventivues (pozicioni i punës nuk është suprimuar).*
- *Znj.E. P para procesit të ristrukturimit ka mbajtur detyrën Ekonomiste Page, Arke, Kosto në Administratën e Qendrës Mekanike Kuçovë dhe pas procesit të ristrukturimit mban detyrën e Ekonomistes në Administratë (pozicioni i punës nuk është suprimuar).*
- *Z.V Gj para procesit të ristrukturimit ka mbajtur detyrën e Ekonomistit të Sektorit pranë Sektorit të Sondës të QMN Kuçovë dhe pas procesit të ristrukturimit mban detyrën e Ekonomistit në Administratën e QMN Kuçovë”.*

Nga ana e Shoqërisë Albpetrol sh.a është sqaruar në vijim se, mbështetur në Strukturën e Re Organizative të miratuar për QMN Kuçovë, janë shkurtuar pozicionet e punës “Ekonomist Sektori”, përfshirë dhe pozicionin e punës të ankuesit “Ekonomist Normist” në Sektorin Mekanik. Ndërkohë që, në administratën e kësaj qendre është shtuar një vend pune “Ekonomist”. Për këtë arsye, ankuesi dhe punonjësit e tjerë me pozicion “Ekonomist Sektori” iu nënshtruan procesit të vlerësimit dhe pikëzimit për konkurimin në vendin e shtuar “Ekonomist” në administratën e QMN Kuçovë. Konkretisht për shkak të ristrukturimit të Shoqërisë janë shkurtuar 12 vende pune “Ekonomist” me shpërndarje në qendra të ndryshme të Shoqërisë dhe pranë QMN Kuçovë 3 pozicione pune “Ekonomist”. Për të zhvilluar një proces të rregullt ligjor dhe transparent, u përfshinë në procesin e vlerësimit dhe pikëzimit të 3 ekonomistët e Sektorit, nga të cilët rezultoi

⁸ Me shkresën me nr.12069/1 prot., datë 10.12.2018.

se z.V. Gj kishte pikët maksimale, duke qenë se arsimi i tij përputhet me arsimin e përcaktuar në Strukturën e Re.

Po ashtu, Shoqëria informon Komisionerin se, për shkak të procesit të ristrukturimit janë prekur 67 punonjës, të cilët deri në dy vjet plotësojnë moshën e daljes në pension, dhe se aktualisht janë ende në marrëdhënie pune 144 punonjës të cilët plotësojnë moshën e daljes në pension deri në dy vjet.

Në shkresë theksohet fakti se, pranë Shoqërisë Albpetrol sh.a pas procesit të ristrukturimit nuk ka patur punësime të reja në pozicionin Ekonomist.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin disfavorizues dhe të pabarabartë të pretenduar nga ankuesi.

Bazuar në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, rezultoi se:

Mbështetur në Programin e Zhvillimit të Rishikuar për vitin 2018, të miratuar me Vendimin nr. 8, datë 07.06.2018, të Këshillit Mbikqyrës dhe Vendimin nr.496/10, datë 25.06.2018, e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Shoqëria Albpetrol sh.a i është nënshtruar procesit të ristrukturimit të saj, si rrjedhojë e të cilit i janë nënshtruar pushimit kolektiv rreth 450 punonjës, që bëjnë pjesë në administratën e kësaj Shoqërie dhe në qendrat e prodhimit e shërbimit në varësi të saj. Nga përmbajtja e akteve të sipërpërmendura rezulton se ky është një proces madhor që po ndodh në këtë Shoqëri, si pasojë e ndryshimeve të treguesve kryesore të Programit të Zhvillimit Ekonomik të shoqërisë “Albpetrol” sh.a për vitin 2018.

Në nenin 147, pika 1, të Kodit të Punës parashikohet: *“Vlerësohet pushim kolektiv nga puna përfundimi i marrëdhënieve të punës nga punëdhënësi, për arsye që nuk kanë të bëjnë me punëmarrësin, kur numri i pushimeve nga puna, brenda 90 ditëve, është, të paktën, 10 punëmarrës për ndërmarrjet me deri në 100 punonjës; 15, për ndërmarrjet me mbi 100 deri në 200 punonjës; dhe 20, për ndërmarrjet me mbi 200 punonjës”*. Numri i punonjësve që i janë nënshtruar pushimit kolektiv pranë Albpetrol sh.a ka qenë rreth 450, fakt që konsiderohet si një pushim kolektiv me përmasa të mëdha.

Në pikën 2, të Vendimit nr.496/10, datë 25.06.2018, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë “Mbi miratimin e ndryshimit të programit të zhvillimit të shoqërisë “Albpetrol” sh.a për vitin 2018” parashikohet shprehimisht: *“Miratimin e procesit të ristrukturimit organizativ të njësisë të Shoqërisë, reduktimit të fuqisë punëtore, strukturës organizative dhe miratimin e numrit total të punonjësve, sipas Vendimit të Këshillit Mbikqyrës nr. 8, datë 07.06.2018, pikat 2,3,4,5,6.”*

Në pikën 2, të Vendimit nr. 8, datë 07.06.2018, të Këshillit Mbikqyrës të Albpetrol sh.a miratohet procesi i ristrukturimit organizativ të shoqërisë dhe reduktimit të fuqisë punëtore, si dhe parashikohet përfundimi i këtij procesi brenda datës 01.10.2018. Në pikën 3 të vendimit në fjalë

Adresa: Rruga e Durrësit, Kodi postar 1001, (Ish-Ministria e Mjedisit), Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: info@kmd.al, web: www.kmd.al

miratohet Struktura Organizative e Shoqërisë “Albpetrol” sh.a me përbërje 3 (tre) Qendra të Prodhimit të Naftës, 7 (shtatë) Qendra Shërbimi dhe Administrata Qendrore. Në këtë vendim miratohet gjithashtu edhe numri total i punonjësve të Shoqërisë prej 1.828 punonjës, pas përfundimit të procesit të ristrukturimit organizativ, të shpërndarë sipas qendrave respektive.

Në kushtet kur fuqia punëtore e kësaj Shoqërie do të reduktohej me rreth 450 punonjës, si dhe duke patur parasysh faktin se ndërmjet Sindikatës së Re të Naftëtarëve Shqiptarë (SRNSH) dhe Albpetrol sh.a është lidhur një kontratë kolektive⁹ për punonjësit e kësaj Shoqërie, në referencë të nenit 148, pika 3, të Kodit të Punës, Albpetrol sh.a bëri këshillime me organizatën sindikale, e njohur si përfaqësuese e punëmarrësve, me qëllim që të arrihet një marrëveshje. Në këtë kontekst u realizuan takime me sindikatën e sipërpërmendur në mënyrë që të përcaktoheshin kriteret për kryerjen e reduktimit të fuqisë punëtore dhe rregullat e përgjithshme, të cilave do t’u nënshtroheshin punonjësit e kësaj Shoqërie të cilët do t’i nënshtroheshin pushimit kolektiv në punë.

Në bazë të Akt-Marrëveshjes së lidhur ndërmjet Sindikatës së Re të Naftëtarëve Shqiptarë (SRNSH) dhe Albpetrol sh.a, si dhe Shtojcës 1 në vijim të kësaj Akt-Marrëveshjeje, kriteret të cilat do të merreshin në konsideratë gjatë procesit të ristrukturimit të shoqërisë dhe reduktimit të fuqisë punëtore ishin: (1) Arsimi, (2) Kualifikimi profesional/kategoria/patent specifike dhe (3) Vjetërsia në punë në industrinë e naftës. Përzgjedhja e punonjësve sipas kriterëve të përcaktuara më sipër do të kryhej sipas vlerësimit me pikë të përcaktuar në këtë marrëveshje. Sipas shpjegimeve të dhëna nga strukturat e Albpetrol sh.a, vlerësimit nëpërmjet sistemit të pikëzimit do t’i nënshtroheshin vetëm ata punonjës, të cilët kishin pozicione të njëjta punë, ndërkohë që nga këto pozicione, disa prej tyre suprimoheshin. Punonjësit, që kishin pozicion pune unik ose të vetëm dhe ky pozicion shkurtohej, nuk i nënshtroheshin vlerësimit nëpërmjet sistemit të pikëzimit.

Në vijim, Albpetrol sh.a miratoi aktet nënligjore, nëpërmjet së cilave përcaktoi rregullat e hollësishme, lidhur me mënyrën se si do të kryhej ristrukturimi dhe reduktimi i fuqisë punëtore. Aktet përkatëse konsistojnë në Urdhërin nr. 49, datë 02.07.2018, të Administratorit për fillimin e procesit të ristrukturimit organizativ dhe reduktimin e fuqisë punëtore të Albpetrol sh.a; Urdhërin nr. 50, datë 02.07.2018, të Administratorit për ngritjen e Komisioneve dhe kryerjen e procesit të ristrukturimit, si dhe Shtojcën nr.1 e cila është pjesë integrale e këtij urdhëri; Urdhërin nr.51, datë 02.07.2018, të Administratorit për përcaktimin e përfaqësuesve të administratës që do të jenë pjesë e komisioneve në Qendrat e Prodhimit dhe Shërbimit, si dhe Urdhërin nr. 63, datë 16.07.2018, të Administratorit të Albpetrol sh.a, lidhur me procedurën e kontrollit dhe Administrimit të procesit të ankimimeve të punonjësve që preken nga ristrukturimi dhe reduktimi i fuqisë punëtore të Albpetrol sh.a.

Në referencë të Akt-Marrëveshjes me Sindikatën e Naftëtarëve, Shoqëria Albpetrol sh.a iu drejtua të gjithë qendrave në varësi të saj, me shkresën nr. 5537, datë 02.07.2018, nëpërmjet së cilës i

⁹Kontrata Kolektive e Punës nr. 8781, datë 29.12.2017, lidhur ndërmjet Shoqërisë “Albpetrol” sh.a. dhe Sindikatës së Re të Naftëtarëve Shqiptarë (SRNSH).

njoftonte në lidhje me përfaqësuesit e Sindikatës së Re të Naftëtarëve Shqiptarë, që do të ishin pjesë e komisioneve të vlerësimit të ngritura në çdo qendër.

Në referencë të Vendimit nr.14, datë 29.08.2018, të Këshillit Mbikqyrës së Albpetrol sh.a, “*Mbi programin e zhvillimit ekonomik të rishikuar për vitin 2018*”, pas kryerjes së ristrukturimit të Shoqërisë, numri i përgjithshëm i punonjësve të QMN Kuçovë është reduktuar me 22 punonjës, në krahasim me numrin e mëparshëm të punonjësve që punonin pranë kësaj qendre. Referuar organikës aktuale të QMN Kuçovë¹⁰, rezulton se janë shkurtuar 3 vende pune si Ekonomist Sektori. Konkretisht, janë shkurtuar pozicionet Ekonomist Sektori: të Sektorit të Fonderisë, Sektorit Elektrik dhe Sektorit Mekanik (ku ishte i emëruar ankuesi).

Për sa më sipër, në strukturën aktuale të QMN Kuçovë rezulton të ketë vetëm një pozicion Ekonomisti të shtuar, në Administratën e kësaj qendre (përveç një pozicioni që ishte dhe në strukturën e vjetër).

Në referencë të përcaktimeve të Urdhërit nr. 50, datë 02.07.2018, të Administratorit për ngritjen e Komisioneve dhe kryerjen e procesit të ristrukturimit, si dhe Shtojcës nr.1, e cila është pjesë integrale e këtij urdhëri, Komisioni i vlerësimit pranë kësaj qendre ka vlerësuar me pikëzim 3 (tre) ekonomistët e QMN Kuçovë. Sikurse është përmendur edhe më sipër, kriteret mbi të cilat u krye vlerësimi me pikëzim, sipas urdhërit të sipërpërmendur ishin: (1)Arsimi, (2)Kualifikimi profesional/kategoria/patent specifike dhe (3)Vjetërsia në punë në industrinë e naftës. Mbështetur në këto kritere, duke iu referuar Proçesverbalit të datës 05.07.2018, rezulton se ata janë vlerësuar respektivisht si më poshtë:

- V.Gj i cili mbante pozicionin Ekonomist Normist pranë Sektorit të Sondës me 55 pikë. (50 pikë është vlerësuar për plotësimin e kriterit të arsimit të lartë “Kontabilitet Financë¹¹” në përputhje me kërkesat e strukturës së re në qendrën përkatëse, 0 pikë për kriterin e kualifikimit profesional, për mungesën e kualifikimit profesional dhe 5 pikë për kriterin e vjetërsisë në punë, pasi ky punonjës ka 4 muaj punë në industrinë e naftës).
- D.L e cila mbante pozicionin Ekonomiste Normiste pranë Sektorit të Fonderisë me 45 pikë. (35 pikë është vlerësuar për kriterin arsimor, pasi rezulton me arsim të mesëm profesional “Dega Ekonomik”, 0 pikë për kriterin e kualifikimit profesional, për mungesën e kualifikimit profesional dhe 10 pikë për kriterin e vjetërsisë në punë, pasi kjo punonjëse ka 9 vjet punë në industrinë e naftës).
- A. P i cili mbante pozicionin Ekonomist Normist pranë Sektorit Mekanik me 40 pikë. (30 pikë është vlerësuar për kriterin arsimor, pasi është me arsim të lartë “Ekonomi Agrare Plani i Lartë”, që nuk përputhet me kërkesat e strukturës së re në qendrën përkatëse, 0 pikë për kriterin e kualifikimit profesional, për mungesën e kualifikimit profesional dhe 10 pikë për kriterin e vjetërsisë në punë, pasi ky punonjës ka 8 vjet punë në industrinë e naftës).

¹⁰ Referuar shkresës nr. 5533/1, datë 02.07.2018, së Administratorit të “Albpetrol” sh.a. drejtuar Q.M.N Kuçovë.

¹¹ Referuar Diplomës me nr.7392, datë 07.12.2015 të Universitetit “Eqrem Qabej”Gjirokastrë.

Referuar Dispozitës së Fundit të Shtojcës 1, të Urdhërit nr. 50, datë 02.07.2018, të Administratorit të Albpëtrol sh.a përcaktohet: *“Në kryerjen e procesit të vlerësimit dhe pikëzimit, Komisioni për të përzgjedhur punonjësit që preken nga procesi i ristrukturimit organizativ dhe të fuqisë punëtore, pavarësisht klasifikimit të mësipërm, do të marrë në konsideratë edhe treguesit e mëposhtëm të performancës në punë:*

- *Masat disiplinore që rezultojnë për atë punonjës;*
- *Vlerësimi i treguesve në punë.”*

Proçesverbali individual i vlerësimit me pikëzim të subjektit ankues, citon: *“Punonjësi A. P, bazuar në urdhërin e brendshëm me nr.107 prot., datë 02.02.2018 ka marrë një vërejtje me shkrim për mosrespektim të orarit dhe kohës së punës”*. Ndërkohë që, në të njëjtin proçesverbal rezulton të jetë shënuar se nga të dhënat e dosjeve të paraqitura për vlerësim rezulton se për dy punonjësit e tjerë V.Gj dhe D.L nuk ka masa disiplinore.

Mbështetur në sa më sipër, nëpërmjet Proçesverbalit nr. 6041/1 prot., datë 18.07.2018, të Komisionit të vlerësimit pranë QMN Kuçovë, subjekti ankues është njoftuar se marrëdhëniet e punës mes tij dhe Shoqërisë Albpëtrol sh.a do të ndërpriten me datë 19.10.2018, pasi referuar procesit të vlerësimit dhe pikëzimit, ai nuk plotësonte kriteret e mjaftueshme për vazhdimin e marrëdhënieve të punës.

Në seancën dëgjimore të zhvilluar në datën 11.12.2018, Komisioneri kërkoi të dispononte dokumentacion, lidhur me performancën në punë të subjektit ankues dhe dy personave të tjerë që i janë nënshtruar procesit të vlerësimit dhe pikëzimit për pozicionin e Ekonomistit të shtuar në Administratën e kësaj qendre (sikurse dhe ankuesi) si dhe vlerësimet që u janë bërë këtyre punonjësve nga eprorët e tyre. Përfaqësuesit e Albpëtrol sh.a u shprehën se nuk ka patur vlerësime në punë të punonjësve gjatë viteve të mëparshme¹², por këtë vit ishte filluar të proçedohet me vlerësimin e punonjësve të Albpëtrol sh.a.

Mbështetur në sa më sipër, Komisioneri gjykon se përzgjedhja e kryer nga Komisioni i Vlerësimit është bërë duke u mbështetur në tre kriteret e përcaktuara: Arsim, Kualifikim, Vjetërsi në punë.

Në përfundim të këtij vlerësimi ka rezultuar se punonjësi me më shumë pikë ishte V.Gj i cili u vlerësua me 55 pikë në total. Subjekti ankues krahasuar me këtë punonjës është penalizuar nga mosplotësimi i kriterit të arsimit të lartë, të specifikuar tashmë arsim i lartë “Financë¹³” si kërkesë për pozicionin e Ekonomistit në strukturën e re të qendrës. Ankuesi kishte arsim të lartë “Ekonomi Agrare Plani i Lartë”.

Në kontekst të sa mësipër, Komisioneri gjykon se subjekti ankues nuk është ekspozuar para një trajtimi të pabarabartë dhe disfavorizues nga ana e Albpëtrol sh.a krahasuar me punonjësin V.Gj, i cili ka rezultuar si fitues në përfundim të procesit të vlerësimit.

¹²Një fakt i tillë u bë i ditur nga strukturat përgjegjëse të Albpëtrol sh.a. edhe gjatë inspektimit të kryer në këtë shoqëri, në kuadër të disa ankesave të tjera pranë KMD-së, nga punonjës të qendrave të tjera të kësaj Shoqërie.

¹³ Kriteri i kërkuar është arsim i lartë “Financë” (pa specifikuar bachelor dhe master).

Ndërsa, lidhur me pretendimin e subjektit ankues se është trajtuar në mënyrë të pabarabartë dhe disfavorizuese, krahasuar me dy punonjësit e tjerë A.K dhe E.P, Komisioneri bazuar në dokumentacionin e depozituar vlerëson se, ankuesi nuk është në kushte të njëjta apo të ngjashme me punonjësit sipërcituar, në mënyrë që të krahasohej me ta, për shkak se:

- Pozicioni i punë së punonjësit A.K nuk është suprimuar. Para ristrukturimit ai ka patur detyrën e Specialistit të Kushteve Teknike dhe Preventive dhe pas procesit të ristrukturimit mban po detyrën e Specialistit Teknik dhe Preventivues.
- Po kështu, pozicioni i punë së punonjësës E.P nuk është suprimuar. Para ristrukturimit ajo ka patur detyrën e Ekonomistes në Administratën e kësaj qendre dhe pas procesit të ristrukturimit mban po detyrën e Ekomomistes së Administratës.
- Ankuesi është në kushte të njëjta me dy punonjësit e tjerë të kësaj qendre, që kanë patur të njëjtën detyrë (Ekonomist Normist) pranë Sektorëve të ndryshëm pranë QMN Kuçovë, V.Gj dhe D.L. dhe mund të krahasohet vetëm me ta.

Lidhur me pretendimin e A. P për diskriminim për shkak të moshës, Komisioneri konstatoi se si rezultat i procesit të ristrukturimit të Shoqërisë Albpetrol sh.a janë prekur 67 punonjës (larguar nga puna si pasojë e pushimit kolektiv) të cilët kanë patur moshën deri në dy vjet para daljes në pension dhe aktualisht janë në marrëdhënie pune 144 punonjës të cilët plotësojnë moshën e daljes në pension, deri në dy vjet.

Komisioneri, vlerëson se subjekti ankues nuk mund të krahasohet me punonjësin që pretendon se është avantazhuar (V.Gj) pasi nuk është në kushte të njëjta me të. V.Gj është vlerësuar me më shumë pikë nga ana e Komisionit të Vlerësimit dhe ky ka qenë elementi që ka prevaluar në shpalljen e tij si fitues i pozicionit Ekonomist në Administratën e qendrës.

Pra, vetë ankuesi dhe V.Gj nuk janë në kushtet e vlerësimit me pikë të barabarta nga ana e Komisionit, që të mund të merrej në konsideratë, për efekt krahasimor elementi “moshë”.

Për sa më sipër, në referencë të nenit 7, pika 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri gjykon se Albpetrol sh.a. nuk ka ndërmarrë veprime që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj ankuesit, ose që e kanë ekspozuar atë, ndaj një trajtimi të padrejtë dhe të pabarabartë, në krahasim me persona të tjerë, që ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme me të.

Në mungesë të trajtimit të pabarabartë, Komisioneri gjykon se nuk kemi të bëjmë me diskriminim për shkakun e bindjes politike dhe të moshës, të pretenduara nga ankuesi.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 18 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 9, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), nenin 1, nenin 7, pika 1,

nenet 11-13, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pikat 10-11,të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit, për shkak të “bindjes politike” dhe të “moshës” të A. P, nga ana e Shoqërisë Albpetrol sh.a.
2. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim, brenda afateve ligjore, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Robert GAJDA

KOMISIONERI

Fusha: Punësim

Shkaku: Mosha, bindjet politike